

BIOLOGJI VI

Ndërveprimi i gjallesave midis tyre dhe me mjedisin

- Dallon veçoritë karakteristike të kafshëve dhe bimëve që jetojnë në vendbanime të ndryshme;
- Tregon se zinxhirët ushqimorë fillojnë me një bimë (prodhuesi) e cila përdor energjinë diellore për të prodhuar ushqimin me fotosintezë;
- Vëzhgon dhe ndërton zinxhirë ushqimorë në një habitat të caktuar; -klasifikon kafshët konsumatore të rendeve të ndryshme (barngrënëse dhe mishngrënëse);
- Ndërton zinxhirë ushqimor për të treguar marrëdhëniet ushqimore në një habitat dhe i paraqet ato në tekst dhe diagram;
- Ndërton dhe interpreton rrjeta ushqimore për të treguar marrëdhënien midis organizmave dhe mjedisit; • klasifikon organizmat sipas rolit të tyre në zinxhirin ushqimor (p.sh., prodhuesit, konsumatorët, dekompozuesit);
- Diskuton mënyra për të parandaluar bimët dhe kafshët nga zhdukja;
- Kryen kërkime për shembuj konkretë të ndikimeve positive dhe negative të njeriut në mjedis;
- Kërkon mënyra të ndryshme për t'u kujdesur për mjedisin p.sh. riciklimi-reduktimripërdorimi, përdorimi me kursim i enegjisë etj.

Njeriu dhe kafshët:

- Përdor emra shkencore për disa prej organe kryesore të sistemeve të trupit të njeriut;
- Identifikon vendosjen e organeve kryesore në trup;
- Përshkruan funksionet e organeve kryesore të trupit;
- Shpjegon se si funksionet e organeve kryesore janë thelbësore për funksionimin normal të organizmit
- Tregon për ndikimin e ushqimeve, drogave, mënyrës së jetesës për funksionimin e trupit të njeriut.

FIZIKË VI

Forcat dhe lëvizja:

- Masa dhe pesha.
- Veprimi i forcave.
- Efektet e forcës.
- Forcat dhe energjia.
- Fërkimi.

– Rezistenca e ajrit .

Nxënësi:

- dallon masën nga pesha e trupit;
- përdor njësitë e masës, forcës dhe peshës;
- identifikon drejtimin e forcës;
- shpjegon energjinë e trupit gjatë lëvizjes së tij;
- **demonstron:**
 - a) llojet e forcës (e tërheqjes, e shtytjes, e fërkimit);
 - b) efektet e forcës (ndryshon lëvizja e trupit dhe forma e tij);
 - c) shkaqet e fërkimit;
 - d) efektet dhe mënyrat e zvogëlimit apo rritjes së forcës së fërkimit;
- përcakton fërkimin (përfshirë rezistencën e ajrit) si forcë që mund të ndikojë në shpejtësinë me të cilën lëvizin trupat.

Elektriciteti:

- Përcjellësit dhe jopërcjellësit e elektricitetit.
- Elementët, simbolet dhe skema e qarkut elektrik në seri.
 - Rezistenca elektrike.

Nxënësi:

- heton cilat materiale janë përcjellës të mirë dhe jo të mirë të elektricitetit;
- identifikon:
 - a) burimet e rrymës elektrike, si: bateri, akumulator, dinamo, bateri diellore;
 - b) elementet përbërëse të një qarku të thjeshtë elektrik dhe simbolet përkatëse (simbolet e baterisë/burimit, llambës, fijeve lidhëse dhe të çelësit);
- heton ndritshmërinë e ndryshme të llambave kur ndryshon:
 - a) numri i elementëve të lidhur në seri;
 - b) lloji i materialit, gjatësia dhe trashësia e përcjellësit që lidh llambat;
- vizaton dhe ndërton diagramën e qarkut elektrik në seri.

MATEMATIKË VI

1.Numri

- Vendvlera, krahasimi i numrave
- Numrat e thjeshtë
- Përafrimi dhe rrumbullakimi
- Vargjet numerike
- Veprime me mend

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE MATEMATIKORE

Zgjidhja problemore : Përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numrat natyrorë , dhjetorë dhe thyesorë .Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme per zgjidhjen e problemave .

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik : Klasifikon numrat natyror , dhjetorë dhe thyesorë.

Të menduarit dhe komunikimi matematik : Demonstron zbatimin e numrave natyrorë , të plotë dhe thyesorë ; komunikon të menduarit e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit , të shkruarit , diskutimit të dëgjuarit , të pyeturit) duke përdorur gjuhën e përditshme , fjalorin fillestar matematik , paraqitje të ndryshme . Mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale : Bën një lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore . Integron njohuritë e sgprenitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme , lëndët e tjera , sportet etj.) integron / lidh koncepte të ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme .

Përdorimi i teknologjisë në matematikë : Përdor makina llogaritëse për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve matematikore.

2.Algebra

- Thyesat
- Shumefishat dhe pjesetuesit (SHVP,PMP)
- Shprehjet shkronjore
- Perqindja
- Raporti dhe perpjesetimi

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE MATEMATIKORE

Zgjidhja problemore : Përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numrat natyrorë , dhjetorë dhe thyesorë .Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme per zgjidhjen e problemave .

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik : Klasifikon numrat natyror , dhjetorë dhe thyesorë.

Të menduarit dhe komunikimi matematik : Demonstron zbatimin e numrave natyrorë , të plotë dhe thyesorë ; Zbaton raportin dhe përqindjen në jetën e përditshme, komunikon të menduarit e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit , të shkruarit , diskutimit të dëgjuarit , të pyeturit) duke përdorur gjuhën e përditshme , fjalorin fillestar matematik , paraqitje të ndryshme . Mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale : Bën një lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore . Integron njohuritë e sgrëhitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme , lëndët e tjera , sportet etj.) integron / lidh koncepte të ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme .

Përdorimi i teknologjisë në matematikë : Përdor makina llogaritëse për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve matematikore.

3. Matja

- Perzgjedhja e pershtatshme e njesive të matjes (njesitë e gjatësisë , të masës dhe të vëllimit), sipas rastit.
- Këmbimi i njesive

4. Gjeometri

- Figurat dhe trupat gjeometrike
- Njehsimi i perimetrit dhe sipërfaqes
- Ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi
- Pozicioni dhe zhvendosja

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE MATEMATIKORE

Zgjidhja problemore : përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra natyrorë , të plotë , dhjetorë , dhe thyesorë . Përdor matjet në figurat 2D për zgjidhjen problemore .Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme për zgjidhjen e problemave .

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik : Klasifikon numrat . Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D.Ndërton figura gjeometrike .

Të menduarit dhe komunikimi matematik :Demonstron zbatimin e numrave natyrorë të plotë ,dhjetorë dhe thyesorë .Kryen matje për figurat 2D.Përdor simbolet gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.Krijon paraqitje të koncepteve matematike (p.sh me mjete konkrete , vizatime) dhe i zbaton në problema nga situata reale ; e mendon matematikën si pjesë të kulturës njerëzore .

Lidhja konceptuale :Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore . Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera , sportet etj.)

Modelimi matematik : Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore .

Përdorimi i teknologjisë në matematikë :Përdor makina llogaritëse për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve matematikore

5.Probabilitet

- Paraqitja e te dhenave,Grafiket
- Kuptimi per probabilitetin

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE MATEMATIKORE

Zgjidhja problemore : Përdor matjet në figurat 2D për zgjidhjen problemore .Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme për zgjidhjen e problemave .

Arsyetingimi dhe vërtetimi matematik : Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D.

Ndërton figura gjeometrike .Sugjeron forma të ndryshme të paraqitjes së të dhënave

Të menduarit dhe komunikimi matematik : Krijon paraqitje të koncepteve matematike (p.sh me mjete konkrete , vizatime) dhe i zbaton në problema nga situata reale. Përdor terminologjinë matematikore (p.sh modë ,mesore ,mesatare aritmetike etj.) për të përshkruar situata të ndryshme dhe nga jeta e përditshme.

Lidhja konceptuale :Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore .

Integron njohuritë e shprehjet matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera , sportet etj.)

Modelimi matematik : Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore

.Përdor grafikët për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë,në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme

Përdorimi i teknologjisë në matematikë :përdor teknologjinë për të komunikuar dhe për të zbuluar informacion matematik